

## STATUT

### I

#### SHOQERISE TREGTARE

“Alb Metal” SH.P.K

#### KREU I

#### FORMIMI , EMRI I SHOQERISE , OBJEKTI , KOHEZGJATJA , SELIA

##### Neni 1.1 Formimi i Shoqerise

Shoqeria eshte themeluar sot me date 01.03.2021 ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret e shoqerite tregtare“ dhe Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Bisnesit ” nga ortaku Dervin Bresha dhe Andi Milo .

##### Neni 1.2 Emri i Shoqerise

Emri i shoqerise eshte “ALB METAL” sh.p.k.

Shoqeria eshte krijuar me mjete ne pronesi private te themeluesit te saj :

- 1) Dervin Bresha i biri i Memos , lindur ne Nivice me karte identiteti nr 035080006, me date 22.02.1992 dhe banues ne Tirane , Rruga Ever Birko, shtepi privat nr 11.
- 2) Andi Milo i biri i Mihal , lindur ne Kucove, me karte identiteti nr 036082918 me date 10.03.1985 dhe banues ne Tirane , Njesia nr 9, Rr Jordan Misja, Godina Rafaelo 2002, hyrja C, Ap1/4

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me Vendimin per krijimin e kesaj Shoqerie ( Akt themelimin dhe Statutin ) dhe legjislacionin Shqiptar .

Ajo rregullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne Shoqeri, te dhenat me rendesi ne qarkullimin juridik , organizimin , objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise .

Shoqeria ka vulen e saj , shkruar Shoqeria “ALB METAL “ sh.p.k.

Shoqeria kryen vepritarine e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

##### Neni 1.3 Objekti i Aktivitetit te Shoqerise .

- Realizimin e aktiviteve ne fushen e konstruksioneve metalike.
- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, ndertim rruge, fusha aviacioni, veshje me asfaltbeton te rrugeve, ndertim veprash arti, ndertim ujesjellesa dhe kanalizimi me.
- Realizimin e veprimeve tregtare per import-eksportin e mallrave industriale, ushqimore me shumice dh pakice
- Hapje e agjensive imobiliare dhe shitblerje dhe dhenie me qera te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme brenda dhe jashte vendit

Tirane 01/03/2021

-Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh.  
-Ne pergjithesi te gjitha aktivitetet industriale tregtare dhe financiare qe lidhen direkte ose indirekte me objektin e shoqerise ose me objekt te ngjahem ose te perafert me te, etj.

Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu edhe aktivite te tjera ndihmese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, te konsideruara me perfitim si dhe te dobishme per arritjen e objektive te saj kryesore . Shoqeria ka te drejte te bashkepusoje me persona ,juridike, me cdo shoqeri tjeter , brenda dhe jashte vendit.

#### **Neni 1.4 Zyrat**

- 1) SELIA e shoqerise eshte ne Rruga Murrize, Vore e Vjeter, prane Auto Servis Picari,njesia kadastrale Nr.2726,Numri i pasurise 20/49.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , mund te hape seli sekondare , filiale , dege ose forma te tjera shoqerish si brenda ashtu dhe jashte territorit te Shqiperise .

#### **Neni 1.5 Kohe Zgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin per nje periudhe kohore pa afat.

**Neni 1.6** Shoqeria pergjigjet me fondet e veta .

### **KREU II**

#### **Neni 2.1 Kapitali**

**Kapitali Themeltare** i shoqerise eshte 100.000 (njqinde mije leke) Leke i ndare ne 2 kuota, ai zoterohet nga ortaket si me poshte

Zoterimi i kapitalit te Shoqerise :

Dervin Bresha **1 kuote ne masen 50%**

Andi Milo **1 kuote ne masen 50%**

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga Ortaket e Shoqerise .

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime .

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

#### **Neni 2.2**

#### **Llojet e Kuotave, te Drejtave dhe Kufizimeve**

Ne perputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese , kuotat mund te emetohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave se ortakeve, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te Ligjit.

### **Neni 2.3**

#### **Çertifikatat e kuotave**

Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certificate per kuoten e zoteruar prej tij. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certificate per kuotat e zoteruara bashkerisht nga disa persona dhe dorezimi i certificates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave do te kosiderohet si dorezim i kryer ndaj te gjithë zoteruesve te kuotave , ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit . Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne cerifikaten e kuotes. Certifikata nuk do te gezoje cilesine e letres me vlere.

### **Neni 2.4**

#### **Kalimi me Kontrate i Kuotave**

(1) Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formaliteteve te percaktuara nga Administratori . Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.

(2) Administratoret mund te refuzojne regjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rast se kjo kuote nuk eshte shlyer plotesisht ose ne rast se Administratoret nuk jane dakort me personin te cilit i kalon kuota.

(3) Nese Administratoret refuzojne te regjistrojne kalimin e kuotes , ata do te njoftojne per mospranimin personin te cilit i kalohen kuota, brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per regjistrimin e kalimit te kuotes.

### **Neni 2.5**

#### **Kalimi i kuotave me Trashegimi ose si pasoje e Falimentimit**

(1) Nese nje ortak vdes, trashegimtari ose trashegimtaret ne rastin e bashkezoterimit te kuotave dhe trashegimtaret e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashgimtar i vetem i bashkezoterusve te kuotave, do te jene peronat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij ; pavareshisht parashikimeve te ketij Statuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjigjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me personat te tjere.

(2) Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratoret, mund te zgjidhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje regjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjetër te cakuar prej tij si perfiues te kuotes. Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje . Nese ky person zgjedh qe nje person tjetër te regjistrohet si zoterues i kuotes, ai kalon kuoten ne dobi te personit tjetër.

(3) Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi ikuotes, duke perjashutar te drejten e pjesmarrjes ose te votes ne cdo mbedhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne QKR.

### **Neni 2.6**

#### **Zmadhimi dhe Zvogelimi I Kapitalit Themeltar**

(1) Asambleja e Pergjithshme , me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi I kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

(2) Shoqeria mund te vendose zvogelimin e kapitalit themeltare te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre me shumicen e kualifikuar te votave.

### **Neni 2.7**

#### **Blerja e Kuotave te Veta**

(1) Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesa per blerjen e tyre , jo nga fitimet e shoqerise qe do t'u shperndahen ortakeve apo emetimi i kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te Ligjit dhe Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese te parashikuara nga ky nen. Ne rast se blerja e kuotave te veta nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te Ligjit , padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te Ligjit.

## **KREU III**

### **Asambleja e Pergjithshme**

#### **Neni 3.1**

#### **Thirrja e Asmablese se Pergjithshme**

(1) Administratoret therrasin Asamblene e Pergjithshme dhe me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te Ligjit, do te procedojne me thirrjen e Asambese se Pergjithshme.

(2) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar me poste ose poste elektronike (email) drejtuar cdo ortaku , perfshire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara dates se cakuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi i mbledhjes se Asamblese se Pergjithsme i cili permban nentedhejte per qind te vleres nominale te kuotave. Secili ortak, se bashku me njoftimin per mbledhjen ,i dergon edhe numrin PIN per te mundesuar pjesermarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.

(3) Mbledhjet e Asamblese se Pergjithsme jane te pavlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme se njoftimit apo mos-marrjes se njoftimit te mbledhjes nga personat te cilet kane te drejte te marrin kete njoftim , me prejashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

#### **Neni 3.2**

#### **Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme**

(1) Asambleja e Pergjithsme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuara nga neni 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire teleconferences (conference call) , audio ose audiovideo, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit . Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjet numrit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

(2) Administratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes si edhe nje person per te mbajtur procesverbalin e saj.

(3) Nese asnje prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese asnje prej Administratoreve nuk eshte i pranishem per pesembedhjet minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Administatori , pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asmablese se Pergjithshme.

(5) Kryetari , me pelqimin e Asamblese se Pergjithsme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund ( dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme) , te shtyje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme , por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme . Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhjetete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi I pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit , nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga :

1. kryetari

2. nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit themeltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku.

(7) Me perjashtim te kundershimit te nje ortaku , deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime, ose me nje shumice te cakuar , nuk eshte miratuar, ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti , pa pasur nevojte per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë , do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

### **Neni 3.3** **Votat e Ortakëve**

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat , çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) i cili është i pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut ( në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt , të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme , personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve , në lidhje me kuoten e zotëuar prej tij, nëse ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votusi do të komunikohet Kryetarit , vendimi I të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

### **Neni 3.4** **Votimi me Prokurë**

(1) Përfaqësuesit do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët) :

(2) Në rastet kur dëshirohet të jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit , caktimi i përfaqësuesit bëhet me Prokurë.

(3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose në kopje e noterizuar apo e miratuar nga Republika e Shqipërisë, sic përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblese së Asamblese se Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme . Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë , në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

(4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email) sipas përcaktimeve të pikë 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

### **Neni 3.5** **Hetimet e posacme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit , duhet të paraqesi një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklaratë noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

## KREU IV

### Administratorët

#### **Shoqeria do te kete 2 (dy) administrator te emeruar:**

Z. Dervin Bresha i biri i Memos , lindur ne Nivice me karte identiteti nr 035080006, me date 22.02.1992 dhe banues ne Tirane , Rruga Ever Birko, shtepi privat nr 11. dhe, Z. Andi Milo i biri i Mihal , lindur ne Kucove, me karte identiteti nr 036082918 me date 10.03.1985 dhe banues ne Tirane , Njesia nr 9, Rr Jordan Misja, Godina Rafaelo 2002, hyrja C, Ap1/4, qe kane të drejtë të veprojë në të gjitha marredhëniet kontraktore dhe finaciare brenda dhe jashtë teritorit Shqiptar

Administratoret do ushtrojne detyrën e tyre me afat për **5 vjet** dhe janë të rizgjedhshëm duke filluar nga data e rregjistrimit në QKB.

#### **Neni 4.1**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

(1) Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorëve , të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë .

(2) Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre cdo komiteti I cili përbëhet nga një ose më shume Administratoë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet qe mund të vendosin Administratorët dhe mudn të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

#### **Neni 4.2**

#### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit.**

Detyra e Administratorit perfundon në rast se :

1. Personi nuk është më Adminitrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. Personi ndodhet në gjëndje paaftësie pagueuse;
3. Personi vuan ose mund të vuajë nga crregullime mendore;
4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë ose ;
5. Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Aministratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme , me propozimein e Administratorëve , vendos ta shkarkojë nga detyra.

### **Neni 4.3**

#### **Shpërblimi , Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve.**

- (1) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për cdo person I cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo I punësuar në shoqëri , shoqëria të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.
- (3) Administratorëve mund t'i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

### **Neni 4.4**

#### **Mbledhjet e Administratorëve**

- (1) Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.
- (2) Vendimet e mbledhjes së Administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga Administratorët dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë dy.
- (3) Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në cdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë cdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rastë se kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm Brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen , Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- (5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve ,apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njeri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin , do të konsiderohen të vlefshme njëllor sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- (6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të



konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëlloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratoëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

#### **Neni 4.5**

##### **Kufizimet e Votimet e Administratorëve.**

(1) Administratoët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë , direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material , qe është apo mund të jete në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakort që :

1. Të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. Te autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë I përgjithshem ose i posacëm për një çështje të caktuar.  
Autorizimi I përgjithsëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara pëfundimit të mbledhjes, dhe vendimi I tij lidhur me cdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës se prerë.

#### **Neni 4.6**

##### **Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve.**

Administratorët kujdesen që në libra të posacëm të mbahen procesverbalet e

1. Të gjitha takimet e kryera nga Administratorët dhe;
2. Të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve te Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje .

## **KREU V**

### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 5.1**

##### **Dividendët**

- (1) Pas plotësimit të parashkimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendeve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashkohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilat paguhet dividend. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividend; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividend do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashkohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- (4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet Brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfihet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### **Neni 5.2**

##### **Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar dhe duke patur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividend preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

## **KREU VI**

### **Prishja dhe Njoftimet**

#### **Neni 6.1**

##### **Prishja dhe Likuidimi**

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë menyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

##### **Neni 6.2: Njoftimet**

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashkimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuara për këtë qëllim dhe personi që kryen njoftimin.

(2) Shoqeria mund te njoftoje nje ortak personalisht ose duke derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar të ortakut ose ne adresen apo postën elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortakut. Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet I jepen përfaqësuesit të tyre te perbashket ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te Ligjit.

(3) Ketij statuti mund ti behen amendamente sa here qe Asambleja e shoh te arsyeshme. Per amendamentet Asambleja duhet te vendose sipas percaktimeve qe bene ligji.

Ky statut nenshkrohet ne vullnet te lire nga ortaket e shoqerise

## **ORTAKET E SHOQERISE**

**“ ALB METAL”**

**Dervin Bresha**



**Andi Milo**

